

Ky dokument përfshin informacionin kryesor për investitorin mbi Fondin SIGAL INVEST. Dokumenti nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohej me ligj, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe rreziqet që shoqërojnë investimin në këtë fond. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo.

Kuotat e Fondit SIGAL INVEST nuk janë depozita dhe nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave, investimi në SIGAL INVEST nuk është një investim i garantuar, SIGAL INVEST nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve dhe rreziku i humbjes së principalit duhet të përballohet nga investitori.

Të dhënat kryesore për Fondin e Investimit

SIGAL INVEST

Sipërmarrje Investimesh Kolektive me ofertë publike, e veçantë dhe me pjesëmarrje të hapur, administrohet nga Shoqëria Administruuese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive "SIGAL Life Uniq Group Austria" Sh.a.

Licensuar nga AMF me licensë nr 13 datë 28.02.2023

Objektivat dhe Politika e Investimit

Objekti i Investimit

Objekti i investimit të Fondit është maksimizimi i kthimit nga investimi nëpërmjet administrimit për një rritje të kapitalit të investitorit në një periudhë afatmesme duke ruajtur nivelet e mjaftueshme të likuiditetit. Fondi është i përshtatshëm për ata investitorë që janë të gatshëm të ndërmarrin një nivel mesatar risku duke investuar në tregun e titujve të borxhit.

Horizonti i Investimit

Rekomandohet që afati minimal për investimin në Fond të jetë të paktën 2 vjet, me synim që të arrihet objektivi i performancës së fondit.

Të ardhurat e Fondit & Kostot

Të ardhurat e Fondit të Investimit nuk shpërndahen, por riinvestohen. Kostot e transaksioneve të portofolit nuk kanë një ndikim material mbi performancën e fondit.

Shlyerja e kuotave

Investitorët kanë të drejtë të kërkojnë në çdo moment shitjen e kuotave që kanë në pronësi të tyre nëpërmjet një kërkesë për shitje. Shlyerja e kuotave në Fond bëhet nga Shoqëria Administruuese jo më vonë se 7 ditë kalendarike nga data e mbërritjes së një kërkesë të vlefshme për shitje.

Kategoritë kryesore të instrumenteve financiare të lejuara të Fondit

Asetet e fondit investohen në instrumente financiare që i përkasin **kategorive kryesore** të aseteve si në vijim:

-Deri në 10% të aseteve të fondit në ekuivalentë "cash"-i, transaksione të anasjellta të riblerjes dhe depozita bankare me maturitet deri në 12 muaj;

-Deri në 90% të aseteve të fondit në tituj borxhi qeveritarë të emetuar ose garantuar nga Republika e Shqipërisë;

- Deri në 30% të aseteve të fondit në tituj borxhi të emetuar nga organet e Qeverisjes Vendore dhe nga shoqëri tregtare vendase, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë

-Deri në 5 % të aseteve të fondit Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tjerë financiarë të borxhit që tregtohen në tregje të rregulluara, në një shtet të Bashkimit Europian, apo në shtete të lejuara nga AMF;

-Deri në 5% të aseteve të fondit në fonde investimi me fokus në tituj borxhi të emetuar në monedhën vendase;

Instrumentet që do të përdoren në zbatimin e politikës së investimit janë: tituj borxhi të emetuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, tituj borxhi të emetuar nga organet e qeverisjes vendore dhe nga shoqëri tregtare vendase të tregtuara në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë.

Fondi nuk duhet të përdoret si një llogari rrjedhëse, por si një mënyrë investimi afatmesme me qëllim sigurimin e një kthimi të kënaqshëm dhe diversifikimin e aseteve.

Rekomandim: Fondi SIGAL Invest mund të mos jetë i përshtatshëm për investitorët të cilët planifikojnë të një qëndrim në fond më të shkurtër se afati 2 vjeçar.

Ndikimi i teknikave të mbrojtjes/arbitrazhit/levës financiare në performancën

Në përbushje të menaxhimit të kërkesave për likuiditeti fondit mund të përdorë mundësinë e:

- Shitjes së letrave nga portofoli dhe
- huamarrjes kryesisht përmes Marrëveshjeve të ri-blerjes.


Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik më i Ulët

Përfitime Tipike më të Ulta
më të Larta

Rrezik më i Lartë

Përfitime Tipike



Profili i Rrezikut dhe Përfitimit të Fondit tregon luhatshmërinë historike të çmimit të kuotës. Bazuar në performancën e kaluar të Fondit, treguesi paraqitet me një numër të plotë, për të renditur fondin në nivel rreziku nga 1 në 7.

Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit sintetik mund të mos jenë të dhëna të besueshme për profilin e ardhshëm të riskut të Fondit SIGAL INVEST. Ato nuk mund të përdoren si indikatorë të qëndrueshëm për të përcaktuar të ardhmen.

Kategoria e treguar e riskut nuk garantohet dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Kategoria më e ulët nuk do të thotë se investimi është pa risk.

Kategoria e SIGAL INVEST

Për Sigal Invest kategoria e parashikuar e treguesit të rrezikut dhe përfitimit vlerësohet në **nivelin 3**, bazuar në politikën e investimit të Fondit SIGAL INVEST. Kjo kategori vlerësohet nga të dhëna historike e tipologjike të bazuara tek volatiliteti i 5 viteve të fundit të tregut të obligacioneve në të cilin fondi planifikon të investojë.

Për rrjedhojë, projeksioni i ardhshëm i profilit mund të ndryshojë.

Megjithatë, duke qenë se ecuria e kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të Letrave me Vlerë të Qeverisë (të cilat në vetvete kanë luhatshmëri relativisht të ulët), parashikimet për të ardhmen janë gjithsesi për ndryshime relativisht të ulta të profilit të riskut.

Rreziqe materialisht të lidhura me Fondin SIGAL INVEST të cilat nuk mbulohen tërësisht nga treguesi i rrezikut sintetik dhe përfitimit janë:

Rreziku i Tregut përfaqëson probabilitetin e krijimit të efekteve negative mbi vlerën e aseteve të Fondit, për shkak të ndryshimeve të tregut.

Rreziku i kredisë është risku i humbjes nga pamundësia që emetuesi i një instrumenti financiar, pjesë e aktiveve të fondit, të përmbushë pjesërisht apo plotësisht detyrimet e tij sipas kushteve të pranuar.

Rreziku i likuiditetit është risku i humbjes kur aktivi në portofolin e fondit nuk mund të shitet, likuidohet apo mbyllet me kosto sa më të ulët brenda një harku kohor mjaftueshëmrisht të shkurtër, duke vënë në rrezik në këtë mënyrë aftësinë e fondit për të përmbushur detyrimet e tij për shlyerje.

Rreziku i palës tjetër është risku që lind nga mospërmbushja e detyrimeve kontraktuale nga pala tjetër ose pala e lidhur e shoqërisë administruese

Risku operacional i referohet humbjes që mund të shkaktohet nga dështim të sistemeve ose gabime njerëzore të shoqërisë administruese.

Komisione dhe Tarifa

Komisionet/tarifat që paguani përdoren për të shlyer kostot e administrimit të Fondit, përfshirë kostot e marketimit dhe shpërndarjes së tij. Komisionet dhe tarifat që kryhen zvogëlojnë rritjen potenciale të investimit.

Komision në Hyrje/ Dalje	0%	Të njehershme
Komision Vjetor Administrimi	1.5% në vit e VNA	Të vazhdueshme
Tarifa e Depozitarit	0.18% e Vlerës neto të aseteve në terma vjetore	Të vazhdueshme
Tarifa e AMF	0.05% e vlerës së përgjithshme të aseteve të fondit	Të vazhdueshme
Tarifa e Auditimit	Në varësi të marrëveshjes që lidhet midis shoqërisë administruese dhe kompanisë së auditimit	Të vazhdueshme
Komisione për shit-blerjen e aseteve të Fondit	Në varësi të Kushteve të Punës të tregut ku kryhet transaksioni	Të vazhdueshme

Komisionet apo tarifat vjetore të vazhdueshme bazohen në shpenzimet e vitit të fundit dhe mund të ndryshojnë nga viti në vit. Në të nuk përfshihen tarifa e performancës dhe/ose kostot e transaksioneve të portofolit, duke përjashtuar rastin e komisioneve dhe tarifave për hyrje dhe dalje të paguara nga Fondi dhe kur blihen dhe shiten kuota të Fondit.

Në asnjë rast, shuma e Kostove dhe Tarifave më sipër nuk mund të tejkalojnë maksimumin prej 3.50% të Vlerës Neto të Aseteve të Fondit (VNA). Lidhur me informacion më të detajuar rreth komisioneve dhe tarifave, ju lutem referojuni seksionit "Komisione dhe Tarifa", në Prospektin e Fondit të Investimit SIGAL INVEST.

Paraqitja e performancës së kaluar

Fondi ka filluar aktivitetin më 19.02.2024 dhe nuk ka të dhëna mbi performancën e kaluar të tij.

Informacion Praktik

Fondi Sigal Invest është miratuar nga Bordi i Autoritetit të Mbiqyrjes Financiare me vendim nr.13, datë 28.02.2023. Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SIGAL UNIQA INVEST sh.a është e licensuar në Republikën e Shqipërisë dhe rregullohet nga Autoriteti i Mbiqyrjes Financiare.

Depozitari i Fondit të Investimit SIGAL INVEST është Banka Amerikane e Investimeve sh.a.

Prospektin, Rregullat e Fondit SIGAL INVEST dhe raportet & pasqyrat financiare mund ti gjeni pranë zyrave të Fondit dhe në <https://fondisigal.com.al/>

Informacioni i përditësuar mbi çmimin e kuotës, vlerës neto të aseteve dhe informacione të tjera të detajuara publikohen në faqen zyrtare të internetit <https://fondisigal.com.al/>

Legjislacioni tatimor i vendit të origjinës të SIK mund të ketë ndikim te pozicioni tatimor personal i investitorit – Shtetas i huaj.

Deklaratë

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SIGAL UNIQA INVEST sh.a është përgjegjëse e vetme për çdo informacion/deklaratë të përfshirë në këtë dokument që është çorientues, i pasaktë ose në kundërshtim me pjesët përkatëse të Prospektit të Fondit.

Ky dokument me informacionin kryesor për investitorin është i saktë në datën e publikimit 11.06.2025

